

# RREGULLORE E SHOQATËS BJESHKATARË DHE ALPINISTË TIRANA

## Hyrje

Rregullorja e Shoqatës përditësohet në dhjetor të çdo viti, për vitin pasardhës, në kohën e takimit të përvitëshëm që organizon Asambleja. Ajo nuk do të jetë rregullore në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale, por do të përmbajë shpjegime të gjykuara si të nevojshme për disa nene të Statutit, rregulla të nevojshme për mbarëvajtjen në drejtim të veprimtarive në natyrë, syzjerime, si dhe synime afatshkurtëra dhe afatgjata të Shoqatës.

## Lënda

### Neni 1

ShBA TIRANA në **synimet afatgjata** do përpiqet që të ndihmojë anëtarët e saj në këto drejtime kryesore:

- Anëtarit të ketë siguracion shëndetësor me pagesë të thjeshtuar gjatë ditëve të veprimtarisë në natyrë;
- Anëtarit të ketë zbritje në kuotat e pagesave për fjetje në bujtina dhe terene të destinuar për fushim (ngritje kampingu);
- Anëtarit të ketë zbritje në pagesat e hyrjeve në parqet kombëtare dhe jo kombëtare;
- Anëtarit t'i sigurohet literaturë që lidhet me rritjen e njohurive për veprimari në natyrë si dhe mundësi informimi lidhur me veprimtari që janë zhvilluar ose do të zhvillohen nga shoqata apo klube që kanë apo kanë patur synime të ngjashme me ato të kësaj Shoqate.

### Neni 2

ShBA TIRANA do të krijojë grupe të organizuara dashamirësish për veprimtari në natyrë me të rinj dhe të reja (ndarazi) nëpërmjet:

- Transmetimit në anëtarët e saj të njohurive të nevojshme për organizimin e veprimtarive në natyrë;
- Aktivizimit periodik të anëtarëve me status *prindër* për të instruktuar fëmijët e tyre me njohuritë e duhura për veprimtari në natyrë;
- Prodhimit e shpërndarjes së literaturës së nevojshme lidhur me elemente njohurishë të domosdoshme për të organizuar veprimtari në natyrë.

### Neni 3

ShBA TIRANA do të ndihmojë anëtarët e saj me rekomandime lidhur me sigurimin/blerjen e bazës së nevojshme materiale për veprimtari në natyrë.

### Neni 4

Të ardhurat nga kuotizacioni do përdoren kryesisht për shpenzimet administrative të Shoqatës.

#### Neni 5

Të ardhurat nga burime të tjera, edhe të tepërtat nga kuotizacioni, do përdoren për të mbështetur pjesërisht ose plotësisht veprimtari në natyrë si dhe veprimtari të tjera që i përgjigjen qëllimeve dhe objektivave të kësaj Shoqate.

#### Neni 6

Anëtari i ri, qoftë ky i kategorizuar aktiv, nderi apo fillestar, ka të drejtë vote pasi të ketë kaluar të paktën pesë muaj jetë në Shoqatë.

#### Neni 7

Anëtari i ri që të rregjistrohet në shoqatë ka këto detyrime:

- Të njihet me Statutin dhe Rregulloren e Shoqatës dhe t'i pranojë ato;
- Të paguaj kuotën vjetore të anëtarësimit;
- Të sigurojë Shoqatën me këto informacione personale: emëri-atësia-mbiemri, dt. lindja, nr. i letërnjoftimit, numuri i komunikimit telefonik, adresa elektronike, arsimi i përfunduar, profesioni.

#### Neni 8

Pagesa për secilën kategori të anëtarësimit në Shoqatë për vitin 2012 dhe 2013 do jetë 2.000 lekë.

#### Neni 9

Pagesa për anëtarësim do jetë një temë e ndryshueshme me tendencë në rritje që do të pasqyrohet në rregullore dhe do të jetë në vartësi të llojit të monedhës në përdorim dhe politikave të kësaj Shoqate, të cilat do përcaktohen nga Kryesia e saj dhe/ose Asambleja e saj.

#### Neni 10

Dhurime të veçanta që merr Shoqata mund të shkojnë direkt në organizimin e veprimtarive të saj.

#### Neni 11

Sponsorizimet që i bëhen shoqatës si dhe dhurime të veçanta për të depozitohen fillimisht në llogarinë rrjedhëse të Shoqatës.

#### Neni 12

Shoqata punon mbi bazën e një plani vjetor të veprimtarive. Planit vjetor miratohet në takimin vjetor (Asambleja) për çdo vit në muajin Dhjetor për vitin në vazhdim. Planit vjetor të veprimtarive i bashkëngjiten nevojat financiare dhe materiale për realizimin e tij. Shoqata mer mendimet e anëtarëve të saj për ndërtimin e planit vjetor të veprimtarive.

### Neni 13

Të gjitha veprimtaritë e ShBA TIRANA zhvillohen nën drejtimin e Kryesisë së Shoqatës (KSh) në bashkëpunim me Komisionin Teknik (KT) të Shoqatës (nëse ky komision është ngritur dhe funksionon). KT do të përbëhet nga tre anëtarë nga më me përvojë që ka Shoqata. Ky komision ngrihet e formësohet nga Kryesia.

### Neni 14

Çdo veprimtari do të zhvillohet në datat e përcaktuara nga KSh sipas një kalendari të miratuar. Nëse për arsye të ndryshme veprimtaria nuk zhvillohet, ose shtyhet për një datë tjetër, të drejtën e rivendosjes së datës e ka KSh.

### Neni 15

Shoqata përgatit anëtarët e saj për drejtimin e veprimtarive që organizon. Titujt “Drejtuës i Veprimtarive Bjeshkuese” dhe “Drejtuës i Veprimtarive Alpinistike” (ose tituj të tjerë që çertifikohen për drejtim veprimtarishë) jepen mbi bazën e kriterëve të Federatës përkatëse Shqiptare ose/dhe kriterëve të përcaktuara nga Komisioni Teknik (KT) i kësaj Shoqate. Çertifikatat e kësaj natyre të lëshuara për anëtarë të ShBA TIRANA nga UIAA, ose persona me licensë nga kjo organizatë janë të pranueshme.

### Neni 16

Çështjet organizative dhe ecuria e çdo veprimtarie që organizon Shoqata përgatiten nga drejtuesi i veprimtarisë, i cili caktohet nga KSh.

### Neni 17

Në veprimtaritë e Shoqatës dhe në ato me karakter kombëtar apo ndërkombëtar merret pjesë me vullnet të lirë. Kriteret mjeksore dhe fizike që caktohen për këto raste për pjesëmarrje janë të domosdoshme.

### Neni 18

Anëtarët e ShBA TIRANA marrin përsipër përgjegjësinë për rrezikun apo aksidentin që mund ndodhë në ngjitjet, lehtizat dhe çdo veprimtari që ndërmarrin në natyrë. Njëherësh, çdo anëtar merr përsipër të kryej vizita të rregullta mjeksore për të përcaktuar aftësitë e tij shëndetësore për veprimtaritë në natyrë.

### Neni 19

Kur veprimtaria kryhet me përfaqësim ekipor, Kryesia dhe/ose Komisioni Teknik cakton trajnerin e ekipit. Trajneri ka fuqi të plota për të përzgjedhur ekipin mbi bazën e normave teknike, fizike, shëndetësore etj., të cilat i gjykon ai.

Neni 20

Baza materiale për çdo veprimtari që organizohet nga ShBA TIRANA sigurohet nga vetë anëtari i kësaj Shoqate.

Neni 21

Në veprimtari alpinistike anëtarët duhet të jenë të moshës 17 vjeç e lart. Nën këtë moshë anëtari duhet të jetë gjatë gjithë veprimtarisë bashkë me të paktën një prind ose kujdestar.

Neni 22

Pjesëmarrja në veprimtaritë Turistike të Shoqatës nuk ka kufizime në moshë por ka përcaktime në program.

Neni 23

Në veprimtaritë e Shoqatës përgjegjësi i veprimtarisë (komandanti) i ndan pjesëmarrësit në grupe me 3 deri 12 anëtarë. Çdo grup duhet të zgjedhë një përgjegjës (drjtuesi i grupit).

Neni 24

Përgjegjësi i veprimtarisë (komandanti) caktohet nga KT apo Kryesia e Shoqatës. Ai është autoritet në drejtim të organizimit dhe drejtimit të veprimtarisë. Kur gjatë veprimtarisë ka raste indisciplinimi dhe thyerje të rregullores nga një anëtar, përgjegjësi i veprimtarisë ka të drejtën e pezullimit të tij nga veprimtaria si dhe të drejtën që t'i propozojë KSh për masa të tjera disiplinore.

Neni 25

Anëtari i Shoqatës pjesëmarrës në veprimtari duhet të ketë disiplinën që kërkon veprimtaria, duhet të respektojë dhe t'i bindet komandantit të veprimtarisë; duhet të shprehë shpirtin e sakrificës për shokët si dhe ndjenjën e bashkësisë dhe të barazisë mes anëtarëve të grupit.

Neni 26

Para fillimit të veprimtarisë anëtari i Shoqatës duhet të jetë i pajisur me të gjithë pajimet e kërkuara për mbarëvajtjen e veprimtarisë. Komandanti e ka për detyrë t'i verifikojë pajimet e çdo anëtari para nisjes për veprimtari.

Neni 27

Nenet e kësaj Rregullore janë në fuqi për çdo veprimtari që organizon ose merr pjesë Shoqata.

## Neni 28

Anëtarët e Shoqatës mund të organizojnë veprimtari të pavarura, të ndërmarra mbi bazë parapëlqimesh që lidhem me interesa të argëtimit në natyrë si dhe/apo parapëlqimeve shoqërore.

## Neni 29

Veprimtaritë me karakter Bjeskimi apo Alpinizmi zhvillohen në natyrë në ato zona ku ngjallet interes dhe dëshirë për anëtarët e Shoqatës për qëllime sportive, ripërtëritjeje dhe/apo argëtuese; për të njohur vendin nëpërmjet të ushtruarit fizik, soditjes, si dhe jetës sociale në natyrë. Veprimtaria mund të zhvillohet në çdo stinë të vitit.

## Neni 30

Detyrat që ka anëtari: i) të bëjë jetë kolektive me anëtarët e Shoqatës në çdo kohë të pjesëmarrjes së tij në veprimtari; ii) të respektojë rregulloren dhe programin e veprimtarisë, përjashto rastet kur është i/e sëmurë; iii) të zbatojë udhëzimet e përgjegjësit të grupit, përveç në ato raste kur ato bien në kundërshtim me rregulloren, programin e veprimtarisë dhe vendimet e Kryesisë së Shoqatës; iv) të zbatojë normat e mirësjelljes dhe të edukatës së shëndoshë gjatë veprimtarisë; v) të jetë i pajisur me ushqime e pajime n'atë masë që të mos bëhet pengesë e grupit për realizimin e synimeve të veprimtarisë; vi) të respektojë etikën e komunikimit me pjesëmarrësit në veprimtari si dhe me popullsinë lokale.

## Neni 31

Përgjegjësi i veprimtarisë së organizuar nga Shoqata, apo i veprimtarisë ku merr pjesë Shoqata (kapo-ja apo komandanti) duhet të jetë anëtar i saj.

- Ai mban përgjegjësi për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë.
- Ai duhet të mbajë lidhje telefonike apo elektronike me Kryesinë.
- Ai duhet të vërë në dijeni me kohë anëtarët e grupit për programin e veprimtarisë dhe t'i njohë ata me rregullat e kampingut dhe të jetës kolektive për rastin.
- Me përfundimin e veprimtarisë i kërkohet, si atij dhe pjesëmarrësve në veprimtari, që të shkruajnë dhe bëjnë me dije antarësinë, si edhe mediat e shkruara dhe vizuale, për kënaqësitë dhe mangësitë e veprimtarisë.

## Neni 32

Përgjegjësi i veprimtarisë dhe, në mungesë të tij, drejtuesi i çdo grupi pjesëmarrësish:

- Duhet të kontrollojë para nisjes në veprimtarinë e ditës pajimet e grupit (materjalin teknik, ushqimet, etj.).
- Duhet që të ndërpresë/përfundojë udhëtimin e ditës të paktën një orë para perëndimit astronomik të diellit nëse i duhet të organizojë ngritjen e kampingut dhe jo më vonë se me perëndimin astronomik të diellit nëse kampingu është i ngritur.

### Neni 33

Pjesëmarrësi në veprimtari duhet:

- Të ketë kryer përgatitjet e duhura fizike dhe teknike si dhe të plotësojë përpara veprimtarisë normat e kërkuara.
- Të njohë dhe të zbatojë rregullat teknike të marshimeve dhe të ngjitjeve si dhe programin e veprimtarisë.
- Të kryejë veprimtari dhe jetë kolektive me anëtarët e grupit.
- Të përmbajë vehten nga veprime dhe/ose veprimtari që nuk janë parashikuar në programin e veprimtarisë.

### Neni 34

Para çdo veprimtarie të Shoqatës jashtë kufijve të Shqipërisë do të krijohet një grup pune me drejtues Mbajtësin e Thesarit, dhe me përbërje një Anëtar të Kryesisë dhe një Anëtar të Shoqatës i cili grup do të vendosë për kriteret e shpenzimeve të cilat do mbulohen nga kjo shoqatë. Në parim, ky grup pune do të përkrahë më shumë, në drejtim të pajisjes me bazë materiale të nevojshme për veprimtarinë, anëtarët e Shoqatës të cilët marrin pjesë në të tilla veprimtari për herë të parë; pastaj ata që kanë marrë pjesë vetëm në një veprimtari, e kështu me rradhë. Thënë ndryshe, fondi do t'iu shpërndahet anëtarëve pjesëmarrës në veprimtari në mënyrë të pabarabartë, duke i dhënë përparësi individëve që kanë mungesa më të mëdha në pajime e veshje. Ky grup pune do mblidhet sapo Kryesia/Shoqata të vendosë për pjesëmarrje në një veprimtari të tillë. Për shpenzimet e tjera të nevojshme dhe më specifike të gjithë pjesëmarrësit në veprimtari do jenë të barabartë.

### Neni 35

Anëtarët e shoqatës, të cilët kanë biznes(e), kanë të drejtë, nëse dëshirojnë, që simbolika të kompanisë së tyre t'ja japin ekipit ose individëve që ngjiten në maja malesh (brënda e jashtë vendit) që të kryejnë foto të cilat mendojnë se do i përdorin për synime reklamash apo të zbukurimit/dekorimit të mjediseve të bizneseve të tyre.

### Neni 36

Anëtarët e shoqatës kanë të drejtë të marrin simbolika të bizneseve të ndryshme për të fotografuar në natyrë a maja malesh me qëllim reklamimin e atyre bizneseve.

### Neni 37

Anëtarët e kësaj Shoqate sygjerohen të programojnë stërvitje individuale të vazhdueshme gjithëvjetore të organizuara në palestra dhe në natyrë. Si Shoqatë do të organizojmë stërvitje me synime mësimore në tema të ndryshme të cilat do t'iu bëhen të ditura anëtarëve në një distancë të arësyeshme kohore nga dita e zhvillimit.

## Neni 38

Për bërthamën alpinistike do organizohen dy teste fizike në vit (Nëntor-Dhjetor dhe Maj-Qershor). Testet do shpallen dhe sipas rasteve rezultatet do të shfrytëzohen (kur lind nevoja) edhe si një nga kriteret e formimit të ekipit alpinistik në një veprimtari.

## Neni 39

### Fotografimet dhe Filmimet

Përcaktimi i kriterëve për detyrimet që kanë anëtarët e SHBA Tirana lidhur me fotografitë dhe filmimet e mara/bëra në veprimtaritë e organizuara apo mbështetura nga Shoqata për: a. Fotot dhe filmimet me flamurët/banerat e sponsorizuesve; b. Fotot dhe filmimet me fazat e ngjitjes së malit. Këto për një veprimtari të organizuar në natyrë, ose në mjedise të tjera.

Shoqata ka nevojë të ketë arkivin e saj si dhe të përdorë këtë arkiv për propagandë apo për qëllime të tjera. Për të siguruar një gjë të këtillë anëtarët e saj pjesëmarrës në një veprimtari duhet të kenë parasysh se:

**Sejcili** që arrin majën e një mali dhe ka aparat rregjistruar (fotografik dhe/ose filmik) e ka **detyrim** fotografimin e ekipit/individit me të gjithë flamurët/banerat e sponsorave aktivë, sponsorave potencialë si dhe organizatave apo individëve që ndihmojnë shoqatën në mënyra të ndryshme.

**Sejcili** anëtar i shoqatës që merr pjesë në ngjitjen e një mali (pavarësisht nëse e arrin apo jo majën) në vartësi të aparateve rregjistruese që ka, e ka detyrim moral të pasqyrojë me foto dhe filmim për arkivin e shoqatës momentet më interesante të të gjithë ngjitjes që kryen.

Fotot dhe filmimet që i dorëzohen shoqatës, duhet të jenë domosdo pa logon/siglën e fotografuesit dhe/apo filmuesit. Këto foto dhe filmime do konsiderohen pronë e shoqatës (dhe pronë e filmuesit apo fotografuesit).

Pronë e shoqatës (ose material për përdorim) konsiderohen edhe foto të tjera dhe filmime të tjera që kanë ose nuk kanë siglën e fotografuesit apo filmuesit dhe që fotografuesi apo filmuesi ja jep shoqatës të drejtën e përdorimit të tyre.

Sa më sipër nuk diferencon vendin dhe kohën ku kryhet veprimtaria.

## Neni 40

Sa herë që kemi mbledhje Kryesie anëtarët krijues të SHBA Tirana (që nuk janë anëtarë të kryesisë së Shoqatës) janë të ftuar të marrin pjesë pa të drejtë vote. Njëherësh, anëtarët e Kryesisë kanë të drejtë të ftojnë si dëgjues në mbledhjet e kryesisë anëtarë të Shoqatës.

#### Neni 41

Në veprimtaritë që do të organizohen nga Shoqata (sipas kalendarit ose për qëllime të tjera) brënda territorit të Qarkut të Tiranës, anëtarët që do të udhëtojnë në makinat e anëtarëve të tjerë duhet të lënë në makinë 200 lekë si kompensim për karburantin. (Thënë ndryshe: anëtarët paguajnë për karburantin e shpenzuar ndërsa Shoqata nuk kompenson).

#### Neni 42

Në veprimtaritë që do të organizohen sipas kalendarit jashtë Qarkut të Tiranës të gjithë anëtarët që do të udhëtojnë në makinë do të japin 400 lekë. Një nga pjesëtarët këto lekë i depoziton në llogarinë e Shoqatës (Raiffeisen Bank SHBA Tirana nr llog 0000633173) me përshkrimin **dhurim** (ose do ja dorëzojnë një prej anëtarëve me të drejtë firme në bankë që të mos paguet komision për depozitim). Nga ana tjetër, shoferi kur nisët nga Tirana e mbush plot serbatorin, gjë që e bën edhe ditën/datën kur kthehet në Tiranë, dhe për faturën/faturat e karburantit të përdorur merr rimbursim të plotë nga Shoqata. (Thënë ndryshe: anëtarët kontribojnë me 400 lekë për karburantin e shpenzuar dhe pjesën tjetër të shpenzimit për karburantin e kompenson Shoqata nga buxheti i saj).

#### Neni 43

Anëtarët e Shoqatës të cilët janë pjestarë të axhensive turistike ose axhensive/ndërmarrjeve të tjera të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me vepritari në natyrë të llojit që organizon kjo Shoqatë, nuk kanë të drejtë që të zgjidhen në Kryesinë e Shoqatës apo të zgjidhen si kryetarë të grupeve/komisioneve të saj të punës.

### **Sygerim: Kujtesë mbi sigurimin teknik të anëtarëve të Shoqatës**

- Mos ndërmerrni udhëtim i vetëm, pa patur përvojën e malit dhe pa patur një shok me përvojë.
- Jini të pajisur mirë me materialin e duhur teknik për veprimtarinë.
- Para nisjes njoftoni përgjegjësin e veprimtarisë për qëllimin dhe itinerarin që do të ndiqni.
- Koha e keqe është gjithmonë e rrezikëshme.
- Mali është i rrezikshëm në ditët kur bie dëborë disa ditë rradhazi.
- Hani shpesh herë gjatë ngjitjeve a marshimeve dhe pini vazhdimisht ujë e lëngje; mos ja lejoni vehtes të shkoni në rraskapitje fizike.
- Kuptimi i vështirësisë nuk duhet të ngatërrohet me atë të rrezikut.
- Nisja herët dhe kthimi shpejt është baraz me siguri.
- Gjatë marshimit në zonat e vështira dhe me rrezik mos kaloni ngadalë nëpër to, por, pasi ta keni studiuar atë më parë, kaloni me përqëndrim të lartë dhe shpejt.
- Mos harroni të merni ujë dhe ushqim tek lini kampin.
- Kampet i ngrini në vende të sigurta si dhe ku ka ujë dhe kushte për të pushuar.

#### Kujdes!

- Të jeni të pajisur mirë, si në dimër dhe në verë, në përputhje me normativat për materiai teknik dhe për veshmbathje. Mos harroni litarët, kazmën dhe kthetrat kur ndërmerrni itinerarë të vështirë.
- Mbi akull të mbuluar nga bora është i detyruar përdorimi i litarit.
- Në të gjithat rastet kur rrugëtimi është me rrezik sigurimi duhet të bëhet me çdo kusht.



- Mbivlerësimi i njhurive dhe aftësive për ngjitje të çon në aventurë.
- Mos u ngjitni në shkëmb pa skicuar në mendje dhe mundësisht në letër rrugëtimin që do të ndiqni; një foto e rrugëtimit e marrë me vehte është edhe më e mirë se sa një skicë.
- Alpinisti e ka rrishtun e jetës me vehte dhe për këtë ai duhet të jetë i vetëdijshëm.
- Mbani gjithnjë plenga e karabina rezervë për të bërë vetë-sigurimin
- Bora e re dhe e shkrifët është e paraprirë për të formuar ortek. Ortekët bien në shpate të pjerrëta dhe në lugje që mbledhin dëborë.

F U N D

Janar 2016